REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 08
Nr. i faqeve / Broj strnnica / No. pages: 1
Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 281
Data / Datum / Date: 25.02.26
PRISHTINE/A NO.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria***
***Vlada-Government***
***Ministria e Ekonomisë***

| | | | |
|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | **KORIGJIM I RVF 2025** | | |
| **PËR/ZA/TO:** | **z. Nysret Koca, u.d. Drejtor i Thesarit-MF;** | | |
| **PËRMES:** | **Znj. Leonita Shabani Mullarama Sekretar i Përgjithshëm, ME** | | |
| **NGA/OD/FROM:** | **Mimoza Berisha Karaqica ZKF, ME** | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Korrigjimi i Raportit Vjetor Financiar për vitin 2025 | | |
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** **ME - PRISHTINË** | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | **25.02.2026** |

**I nderuar z. Koca,**

Në përputhje me njoftimin nga Thesari i Kosovës, ju përcjellim **korrigjimet e nevojshme për Raportin Vjetor Financiar për vitin fiskal 2025**.

Korrigjimet e bëra kanë të bëjnë kryesisht me çështje teknike, sipas komunikimeve dhe sqarimeve të zhvilluara me ekipin e ZKA-së. Çdo ndryshim është i dokumentuar dhe i arsyetuar në mënyrë të qartë në dokumentacionin bashkëngjitur.

**Ndryshimet janë reflektuar në:**

1. **Neni 14 – Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit**
   - **Të hyrat jo-tatimore** – janë përditësuar **Buxheti Fillestar (projeksioni)** dhe **Buxheti Final** sipas projeksionit të Ministrisë së Financave.
   - **Realizimi i të hyrave** është ndarë në dy kategori: **të hyrat jo-tatimore të vitit 2025** dhe **të hyrat nga viti i kaluar**.
2. **Neni 14.6 – Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit**
   - Është vendosur vlera e buxhetit fillestar për të hyrat jo-tatimore sipas projeksionit të Ministrisë së Financave.
   - Është bërë ndarja e kategorive të të hyrave për t'u përputhur me realizimin faktik.
3. **Shënimi 9 – Të hyrat jo-tatimore**
   - Janë sqaruar në detaje burimet e të hyrave jo-tatimore dhe **dallimi midis projeksionit dhe realizimit**, duke përfshirë kthimet e mjeteve nga viti i kaluar dhe të hyrat e reja nga projekte dhe shërbime.

Me respekt,

# Gabimet e identifikuara gjate rishikimit të PVF-ve për Minisrinë e Ekonomisë për Viti 2025

**Rishikimi i Pasqyrave Vjetore Financiare nga ZKA**

**Çështjet e identifikuara janë si ne vijim:**

**Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit**

**Buxheti fillestar dhe final për të hyrat jo tatimore-** të bëhen korrigjimet sipas projeksionit të të hyrave nga Ministria e Financave. (bashkangjitur gjeni dokumentin-prohkesionin e te hyrave.

**Vëmendje: Vlerat që ne i kemi rekomanduare për tu korrigjuar ju lutem ti adresoni deri me datë 26.02.2025.**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 08-2/150 Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 209/2025
Nr. i fletëve / Broj stranica / No. pages: 8 Data / Datum / Date: 20.01.2025
PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers***

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 20 Janar 2025 |
| **REFERENC-Ë:** | /2025 |
| **PËR/ZA/TO:** | Zyrtarët Kryesor Administrativ dhe Zyrtarët Kryesor Financiar |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **CC:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Blerta Kika zv. Drejtor DPE/MFPT |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Informim lidhur me projeksionet e të **Hyrave Jo -Tatimore - Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror për periudhën 2025 - 2027** |

Të nderuar!

Bazuar në udhëzimet e Shkresës Nr. 1259/2024 Qarkorja e Buxhetit 2025/01 për përgatitjen e projekt Buxhetit 2025-2027, dërguar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 15 maj 2024, si vazhdimësi e procesit te KASH-it, udhëzohen Organizatat Buxhetor gjatë përgatitjes së projeksioneve për periudhën trevjeçare, të përfshijnë edhe parashikimet e të hyrave jo-tatimore për periudhë trevjeçare.

Kuvendi me datën 25 nëntor 2024 ka miratuar Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, të Hyrat Jo -Tatimore -Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror për vitin 2025 në total janë parashikuar në shumë prej 190.92 milion Euro.

Nisura nga këto procese, duke marrë ne konsideratë projeksionet konkrete të disa organizatave buxhetore të pranuara gjatë procesit te buxhetit dhe bazuar në të dhënat historike; kemi përgatitur projeksionet sipas OB (organizatave buxhetore), për periudhë trevjeçare Buxheti 2025-2027.

Për më shumë detaje kemi bashkangjitur tabelën në vijim me projeksionet e të Hyrave Jo -Tatimore - Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror për periudhën 2025 -2027!

Me respekt!

# LIGJI NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025

## Të Hyrat Jo -Tatimore -Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror sipas OB [1]

| OB | ORGANIZATA | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Buxhet | Buxhet | Proj. | Proj. |
| 101 | KUVENDI [2] | 47,812 | 4,108 | - | - | - | - | |
| 102 | ZYRA E PRESIDENTIT [2] | - | 414 | 9,827 | - | - | - | |
| 104 | ZYRA E KRYEMINISTRIT | 7,081,538 | 6,890,735 | 1,435 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,697 |
| 201 | MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE | 5,766,185 | 9,134,785 | 6,660,327 | 8,524,241 | 9,338,582 | 10,712,074 | 10,144,020 |
| 203 | MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL | 2,680,063 | 2,570,437 | 9,279,729 | 9,791,667 | 9,909,137 | 10,229,137 | 10,663,948 |
| 204 | MINISTRIA E INDUSTRISË,NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË | 2,483,017 | 2,609,786 | 2,105,854 | 2,845,380 | 3,117,206 | 3,241,877 | 3,271,625 |
| 205 | MINISTRIA E MJEDISIT,PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS | 6,107,582 | 4,691,164 | 5,012,536 | 6,249,811 | 6,846,870 | 7,120,707 | 7,186,047 |
| 206 | MINISTRIA E SHËNDETËSISË | 5,301,986 | 5,842,047 | 6,128,450 | 6,827,214 | 7,479,435 | 7,778,571 | 7,848,947 |
| 207 | MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT | 58,412 | 139,703 | 88,847 | 113,426 | 124,282 | 129,232 | 130,418 |
| 208 | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT | 2,434,375 | 2,736,560 | 2,357,696 | 2,975,807 | 3,260,093 | 3,390,479 | 3,421,590 |
| 211 | MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM [2] | 2,778 | - | 11,645 | - | - | - | - |
| 213 | MINISTRIA E EKONOMISË | 2,400 | 1,113 | 121,181 | 49,279 | 53,987 | 56,146 | 56,661 |
| 214 | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | 66,588,068 | 69,677,161 | 72,437,917 | 82,493,128 | 90,373,897 | 93,988,357 | 94,850,792 |
| 215 | MINISTRIA E DREJTËSISË | 127,803 | 1,085,091 | 105,443 | 521,093 | 15,570,874 | 593,706 | 5,674,166 |
| 216 | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORA | 5,871,089 | 6,219,219 | 5,392,320 | 6,910,278 | 7,570,433 | 8,173,210 | 8,048,302 |
| 217 | MINISTRIA E MBROJTJES | 6,175 | 165,919 | 169,694 | 135,097 | 148,003 | 163,923 | 158,763 |
| 220 | SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITAR I KOSOVËS | 2,645,850 | 3,230,451 | 3,759,915 | 3,808,863 | 4,172,733 | 4,539,619 | 4,448,005 |
| 221 | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | 28,225 | 7,500 | 14,195 | 19,732 | 21,617 | 22,481 | 22,688 |
| 224 | FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR | 57,201 | 128,723 | 57,171 | 96,087 | 105,267 | 169,477 | 131,051 |
| 231 | AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS [3] | 4,659 | 8,472 | 4,655 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,697 |
| 235 | AUTORITETI RREGULLATOR I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTAR[3] | 6,359,514 | 16,449,723 | 7,509,758 | 7,486,490 | 9,443,711 | 13,212,616 | 10,833,629 |
| 238 | ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGJISË SË KOSOVËS[3] | 1,401,716 | 1,174,798 | 7,638,992 | 6,614,000 | 1,000,000 | 1,100,000 | 3,285,291 |
| 239 | AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT [2] | - | 1,220 | - | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 240 | ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT | 18,296 | 125,712 | 459,842 | 238,681 | 261,483 | 271,941 | 274,436 |
| 241 | AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS [2] | 170 | - | - | - | - | - | - |
| 242 | UNIVERSITETI I PRISHTINËS | 1,492,249 | 1,530,124 | 1,380,371 | 1,740,252 | 1,906,503 | 2,282,752 | 2,103,794 |
| 243 | GJYKATA KUSHTETUESE [2] | - | - | 904 | - | - | - | - |
| 244 | AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS [3] | 7,025 | 26,300 | 171,700 | 21,700 | 24,800 | 21,700 | 24,262 |
| 245 | AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELEGJENCË [2] | 9,193 | - | - | - | - | - | - |
| 246 | KËSHILLI KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE [2] | - | - | 2,445 | - | - | - | - |
| 247 | PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA [2] | 237,300 | 39,400 | 6,514 | - | - | - | - |
| 250 | KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES | 16,245 | 11,330 | 46,960 | 29,461 | 32,276 | 33,566 | 33,874 |
| 251 | AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI | - | 105,000 | 22,500 | 50,792 | 55,644 | 57,889 | 58,400 |
| 253 | AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE [2] | 7,666 | 13,590 | - | - | - | - | - |
| 254 | AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR [3] | - | 8,493 | 34,772 | 6,045 | 6,160 | 6,160 | 6,545 |
| 302 | ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT | 39,191 | 9,880 | 15,680 | 25,507 | 27,944 | 29,061 | 29,328 |
| 313 | AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT | 400,603 | 403,935 | 444,345 | 493,840 | 540,799 | 572,428 | 571,017 |
| 314 | AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE | 1,500 | 24,585 | 8,550 | 13,690 | 14,998 | 15,598 | 15,741 |
| 317 | AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS [3] | 2,054,903 | 2,899,912 | 3,344,034 | 5,101,166 | 5,202,510 | 5,502,510 | 5,626,639 |
| 318 | KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE | 794,710 | 1,204,653 | 904,784 | 1,147,909 | 1,257,572 | 1,317,867 | 1,323,297 |
| 319 | KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA | 362,894 | 315,845 | 390,732 | 422,725 | 453,108 | 491,630 | 489,478 |
| 320 | KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE [2] | 45,291 | 1,314 | 6,600 | - | - | - | - |
| 321 | INSTITUCIONI I AVOKATIT TE POPULLIT [2] | 177 | - | 1,420 | - | - | - | - |
| 328 | KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES | 9,019,139 | 8,821,598 | 10,191,248 | 11,475,338 | 12,571,605 | 13,174,401 | 13,228,654 |
| | GJITHSEJ | 129,563,000 | 149,310,580 | 146,301,368 | 166,248,499 | 190,921,509 | 188,419,096 | 193,786,800 |

## Mimoza Berisha

**From:** Ganimete Dalloshi <ganimete.dalloshi@oagks.org>
**Sent:** Tuesday, February 24, 2026 11:14 AM
**To:** Mimoza Berisha
**Cc:** Mehmet Mucaj
**Subject:** Letër Përjashtimi- PFV 2025
**Attachments:** Hyrat e Planifikuar.pdf; Letër Përjashtim PVF-2025.docx

Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sender

Përshëndetje Mimoza,

Ashtu siç biseduam po ju dërgoj projeksionin e të hyrave dhe letër përjashtimin.

Me respekt,
Ganimetja

---

**From:** Mimoza Berisha <Mimoza.Berisha@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, February 24, 2026 9:03 AM
**To:** Ganimete Dalloshi <ganimete.dalloshi@oagks.org>
**Cc:** Leonita Shabani Mullarama <Leonita.Shabani@rks-gov.net>; Nehat Rrahimi <Nehat.Rrahimi@rks-gov.net>
**Subject:** Plotësim sqarimi – paraqitja e projeksionit të të hyrave në RVF 2025

E nderuar znj. Dasholli,

Ju njoftoj se në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit (neni 14), përveç realizimit, është paraqitur edhe projeksioni i të hyrave.

Dallimet materiale ndërmjet projeksionit dhe realizimit janë sqaruar në Shënimet 2–12, përkatësisht në përputhje me kërkesat e SNKSP (bazuar në para të gatshme), ku kërkohet shpalosja e dallimeve materiale në kolonën përkatëse.

Nëse nevojiten sqarime shtesë, mbetem në dispozicion.

Me respekt,

---

**From:** Mimoza Berisha
**Sent:** Monday, February 23, 2026 9:43 AM
**To:** 'Ganimete Dalloshi' <ganimete.dalloshi@oagks.org>
**Cc:** Leonita Shabani Mullarama <leonita.shabani@rks-gov.net>; Nehat Rrahimi <Nehat.Rrahimi@rks-gov.net>
**Subject:** Sqarim lidhur me të hyrat jo-tatimore për vitin fiskal 2025

**From:** Mimoza Berisha
**Sent:** Monday, November 10, 2025 11:24 AM
**To:** 'Ganimete Dalloshi' <ganimete.dalloshi@oagks.org>
**Cc:** Agim Thaci <Agim.Thaci@rks-gov.net>
**Subject:** Sqarim- të hyrat

**E nderuar,**

Bashkëlidhur gjeni raportin për të hyrat e Ministrisë për periudhën janar – nëntor 2025.

Të hyrat nga **Fraunhofer - Gesellschaft zur Förderung** nuk kanë mundur të planifikohen, pasi me marrëveshjen fillestare ishte paraparë që të mbulohen shpenzimet e pjesëmarrësve – punonjës të Ministrisë. Megjithatë, gjatë vitit 2024 kemi marrë njoftim se kompensimi i këtyre shpenzimeve nuk do të realizohet, por në vend të kësaj do të bëhet pagesa e participimit deri në **5,000 euro në vit** për secilin anëtar të këtij mekanizmi.

| | |
|---|---|
| Pranim i mjeteve nga Fraunhofer - Gesellschaft zur Foerd për Ministrinë e Ekonomisë . Raporti i dt.23.05.2025 | 20,000.00 |
| Pranim i mjeteve nga Fraunhofer -Gesellschaft zur Foerd për Ministrinë e Ekonomisë.Raporti dt. 24.10.2025 | 4,500.00 |

Për çdo paqartësi jemi në dispozicion.

**Me respekt,**

**Mimoza Berisha Karaqica**
Udhëheqëse e Divizionit për Financa dhe Kontabilitet
Departamenti i Financave
Ministria e Ekonomisë

PHONE +383 (0)38 200 21 568
EMAIL Mimoza.berisha@rks-gov.net

Ky mesazh është konfidencial. Nëse keni pranuar këtë mesazh gabimisht, ju lutem na njoftoni menjëherë me e-mail dhe fshini atë nga sistemi juaj. Ju nuk mund të kopjoni këtë mesazh ose të bëni publik përmbajtjen e tij.
This message is confidential. If you have received it by mistake, please let us know by e-mail reply and delete it from your system; you may not copy this message or disclose its contents to anyone.

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Emri i organizatës buxhetore në gjuhen shqipe** Ministria e Ekonomisë
***Emri i organizatës buxhetore në gjuhen serbe*** (shkruaj emrin e OB-së)

**Kodi i Organizatës buxhetore** 213

# Raporti Vjetor Financiar

# I Korrigjuar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit 08
Nr. Prot. Br. Prot Prof.No: 281
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages
Data: Datum. Date: 25.02.26
PRISHTINE/A NO.1

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

## Neni 12
## DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **Nysret KOCA, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Leonita SHABANI MULLARAMA, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

**Mimoza BERISHA KARAQICA, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2025.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatorë të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuara janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të institucionit MINISTRIA E EKONOMISË.

**Data:** 25/02/2026

*(Nënshkrimi i ZKA)*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË - MINISTARSTVO EKONOMIJE - MINISTRY OF ECONOMY
Prishtinë

**Datë:** 25/02/2026

*(Nënshkrimi i ZKF)*

## Neni 13
## Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

### Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për MINISTRIA E EKONOMISË
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

| | Shënim | 2025 | 2024 | 2023 |
|---|---|---|---|---|
| | | Llogaria e vetme e Thesarit | Llogaria e vetme e Thesarit | Llogaria e vetme e Thesarit |
| | | BKK '000 | BKK '000 | BKK '000 |
| **BURIMET E FONDEVE -PRANIMET** | | | | |
| Granti qeveritar | | 25,979 | 48,748 | 51,936 |
| Të hyrat vetanake | | | | |
| Të hyrat e dedikuara | | | | |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | | | | |
| Financimet nga huamarrja | | 711 | 4,371 | 5,577 |
| Klauzola e investimeve | | 2,390 | 2,924 | 144 |
| Fondi zhvillimor në mirëbesim | | | | |
| Pranimet tjera | | | | |
| **Gjithsej** | | **29,080** | **56,043** | **57,657** |
| **SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT** | | | | |
| Operacionet | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 1,547 | 1,476 | 1,383 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 1,487 | 3,106 | 2,014 |
| Shpenzime komunale | 4 | 13 | 17 | 13 |
| | | **3,046** | **4,600** | **3,411** |
| Transferet | | | | |
| Transfere dhe subvencione | 5 | 22,726 | 46,207 | 50,991 |
| Shpenzime kapitale | | | | |
| Prona, ndërtesa dhe pajisje | 6 | 3,308 | 5,236 | 3,255 |
| Pagesa tjera | 7 | | | |
| **Gjithsej** | | **29,080** | **56,043** | **57,657** |

***Shënim:*** *Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.*

## Neni 14
## Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për MINISTRIA E EKONOMISË

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

| | | 2025 | | | | 2024 | 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Realizimi | Buxheti final | Buxheti fillestar | Ndryshimi | Realizimi | Realizimi |
| | | A | B | C | D=B-A | E | F |
| | Shënime | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| HYRJA E PARASË SË GATSHME | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | 8 | | | | - | | |
| Të hyrat jo tatimore | 9 | 155 | 54 | 54 | (101) | 16,477 | 118 |
| Të hyrat e dedikuara | 10 | | | | - | | |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 11 | | | | - | | 3 |
| Të hyrat nga viti i kaluar | 12 | 183 | - | - | (183) | | |
| Gjithsej Pranimet | | 338 | 54 | 54 | (284) | 16,477 | 121 |
| DALJA E PARASË SË GATSHME | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 1,547 | 1,547 | 1,776 | - | 1,476 | 1,383 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 1,487 | 5,715 | 6,782 | 4,228 | 3,107 | 2,014 |
| Shpenzime komunale | 4 | 13 | 17 | 23 | 5 | 17 | 13 |
| Transfere dhe subvencione | 5 | 22,726 | 23,976 | 22,904 | 1,250 | 46,207 | 50,991 |
| Shpenzime kapitale | 6 | 3,308 | 6,950 | 8,800 | 3,642 | 5,236 | 3,255 |
| Rezerva | | | | | | | |
| Tjerat | 7 | - | - | - | - | - | - |
| Gjithsej pagesat | | 29,080 | 38,205 | 40,285 | 9,125 | 56,043 | 57,657 |

## Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D** *(neni 14)* , domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkohen ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës ndryshimit.

### Shënimi 9: Realizimi i të hyrave për vitin fiskal 2025

Gjatë vitit fiskal 2025, të hyrat janë realizuar nga burime të ndryshme, si më poshtë:

1. Të hyrat nga projekti ODYSSEE-MURE - Shuma prej 25,500.00 Euro rrjedh nga pjesëmarrja në projektin ODYSSEE-MURE, në kuadër të programit LIFE të Bashkimit Evropian. Këto të hyra janë realizuar përmes një kontrate nënkontraktimi me Fraunhofer-Gesellschaft zur Förderung der angewandten Forschung e.V., ku institucioni ynë ka vepruar si palë ofruese e shërbimeve profesionale. Këto të hyra nuk kanë qenë të planifikuara paraprakisht për vitin 2025, pasi kompensimi i shpenzimeve të pjesëmarrësve nuk realizohej si rimbursim, por përmes pagesës së participimit për secilin anëtar të mekanizmit.
2. Të hyrat nga qiraja e objektit solar në Kramovik – Nga subjekti juridik janë arkëtuar dy pagesa për qiranë në shumën prej 125,643.50 Euro dhe 257.00 Euro.
3. Të hyrat nga shitja e shërbimeve dhe participimet tjera – Janë realizuar dhe arkëtuar nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Inspektorati i Energjisë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore dhe ofrimit të shërbimeve përkatëse.

### Shënimi 12: Të hyrat nga viti i kaluar

Gjatë vitit fiskal 2025, në kategorinë e të hyrave jo-tatimore është evidentuar shuma prej 183,062.43 Euro, e cila përfaqëson kthimin e mjeteve financiare të paguara gabimisht gjatë vitit 2024. Këto mjete janë regjistruar në vitin fiskal 2025 në përputhje me nenin 41.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Në tabelën e raportimit të SIMFK-së, kjo shumë është paraqitur si të hyra nga viti i kaluar, duke reflektuar saktësisht burimin dhe natyrën e saj si korrigjim i vitit fiskal 2024. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk ka qenë e planifikuar për vitin 2025.

### Shënimi 5: Subvencionet dhe transferet

Në vitin fiskal 2023/2024 është evidentuar një dallim material i shpenzimeve krahasuar me vitin 2025. Ky ndryshim është rezultat i zbatimit të masave qeveritare për tejkalimin e krizës energjetike, përfshirë:

- Subvencionimin e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët fundor.
- Subvencionimin e importit të energjisë elektrike.

Këto masa kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për subvencione dhe transferte gjatë viteve 2023/2024, ndërsa shpenzimet e vitit 2025 janë realizuar në nivele më të ulëta, pas zbutjes së krizës energjetike.

## Neni 15
## Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Projektet që janë pjesë e Tabelës 3.2 B (Financimi me Klauzolën e Investimeve), për vitin 2025:

1. Impianti për ujëra të zeza ne Komunën e Prishtinës, financimi i planifikuar: 500,000;
2. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujerave të zeza - Ferizaj, financimi i planifikuar: 5,000,000;
3. Impianti për Trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë, financimi i planifikuar: 500,000;
4. Projekti i zhvillimit të ujërave të zeza në Gjilan dhe Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave në Gjilan, financimi i planifikuar: 2,450,000;
5. Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza Mitrovicë, financimi i planifikuar: 1,000,000,

Bëhet fjalë për projekte për të cilat **fondet mbahen në Ministrinë e Ekonomisë**, ndërsa proceset e tjera që lidhen me **menaxhimin dhe prokurimin** e tyre janë përgjegjësi e **KRU-ve.**

Gjatë vitit **2025, KUR Mitrovica** nuk ka arritur të zhvillojë aktivitetet e prokurimit dhe/apo të fillojë punimet për projektin për të cilin fondet kanë qenë të **alokuara**. Si rezultat, **shfrytëzimi i fondeve të ndara për këtë projekt gjatë vitit 2025 ka qenë zero**. Ministria e Ekonomisë, gjatë gjithë vitit 2025, ka zhvilluar takime dhe ka komunikuar vazhdimisht me **Ndërmarrjet Publike (NP)**, duke kërkuar raportim lidhur me vështirësitë në realizimin e projektit. Megjithatë, pavarësisht zotimeve të dhëna, **realizimi i projektit dhe shfrytëzimi i fondeve nuk kanë mundur të realizohen**.

Ndërkaq, për projektet **"Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza - Ferizaj"** dhe **"Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë", nuk janë zhvilluar aktivitete apo iniciativa konkrete në drejtim të realizimit të tyre, rrjedhimisht nuk janë alokuar fondet gjatë vitit 2025.**

### Shënimi 1

### 1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116,Ligjin nr. 04/L-194,Ligjin nr. 05/L-063 , Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 Për mbështetjen e punëve publike.

### 1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

**Misioni i Ministrisë së Ekonomisë**
Ministria e Ekonomisë (ME) harton dhe zbaton politika të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja në energji, miniera dhe sektorin e ICT-së, garanton konkurrencën dhe një treg të sigurt, siguron zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike e minerale të vendit, zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe teknologjisë informative, garanton profesionalizëm në administrimin e ndërmarrjeve publike dhe ristrukturimit ekonomik përmes transformimit të pronësisë, modernizimit dhe ngritjes së efikasitetit

të ndërmarrjeve publike, të cilat do të arrihen përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve si dhe realizimit të aktiviteteve tjera në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Baza ligjore e formimit dhe funksionimit të Ministrisë se Ekonomisë

Entitet i sektorit publik MINISTRIA E EKONOMISË ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116,Ligjin nr. 04/L-194,Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007, Ligjin 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025 si dhe Vendimeve të QRK për rregullim dhe shtim të masës monetare.
Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës se Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

| Emri i dokumentit bazë | Data e miratimit |
|---|---|
| LMFPP Nr. 04/L-048 | |
| VENDIMI I KUVENDIT TË KOSOVËS PËR ZGJEDHJEN E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 846/2 | 24 MARS 2021 |
| LIGJI NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 | 12 DHJETOR 2024 |
| Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-1941 | 25.09.2015 |
| KMF Rregullat e Thesarit, | |
| Udhëzim administrativ (QrK) Nr. 03/2015 për Vlerësim të Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare | 06.05.2015 |
| Rregullore (QRK) Nr. 01/2024 Per disiplinën e nëpunësve civil | 24.01.2024 |
| Udhëzimi Administrativ Nr.18/2015 për procedurë e ankesave | 18.05.2015 |
| Rregulloren Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare | 2013 |
| VQ-Nr. 22/269 | 19.09.2025 |
| VQ-Nr. 01/281 | 24.12.2025 |
| VQ-Nr. 03/261 | 24.12.2025 |
| Nr. 01/279 | 15.12.2025 |
| Nr. 01/282 | 26.12.2025 |
| VQ-Nr. -04/282 | 26.12.2025 |

## 1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

## 1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:
13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),
16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

## 1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

## 1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesor Administrativë dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

## Neni 14.6
## Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

| Kategoria e ndarjes | Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000 | Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP: Ndryshimi I-VQ Nr. 22/269 € '000 | Ndryshimi II-VQ 01/281-03/261 € '000 | Ndryshimi III-VQ 01/279 € '000 | Ndryshimi IV-VQ 01/282; 04/282 € '000 | Të hyrat vetanake € '000 | Grantet e percaktuara te donetoreve € '000 | Neni 9 € '000 | Buxheti përfundimtar SIMFK € '000 | Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Hyrjet** | | | | | | | | | | |
| Të hyrat jo tatimore | 54 | | | | | 155 | | | 209 | |
| Të hyrat nga viti i kaluar | - | | | | | 183 | | | 183 | #DIV/0! |
| Gjithsej | 54 | - | - | - | | 338 | - | - | 392 | |
| **Daljet** | | | | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 1,776 | | (230) | | | | | | 1,546 | -12.95% |
| Mallra dhe shërbime | 6,782 | | | | (1,067) | | | | 5,715 | -15.73% |
| Shpenzime komunale | 23 | | | | (6) | | | | 17 | -24.99% |
| Transfere dhe subvencione | 22,904 | 616 | | | 457 | | | | 23,976 | 4.68% |
| Shpenzime kapitale | 8,800 | | | (1,850) | | | | | 6,950 | -21.02% |
| Gjithsej | 40,285 | 616 | (230) | (1,850) | (616) | 0 | 0 | 0 | 38,205 | -5.2% |

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë**

Hyrjet: dallimi mes buxhetit fillestar dhe final

Dallimi midis **buxhetit fillestar** (projeksionit) dhe **buxhetit final** për **të hyrat jo-tatimore** dhe **të hyrat nga viti i kaluar** shpjegohet me faktin se buxheti fillestar pasqyron vetëm projeksionin e Ministrisë së Financave, ndërsa buxheti final përfshin **realizimin e plotë të të hyrave** gjatë vitit 2025, duke përfshirë:

- Kthimet e mjeteve të vitit të kaluar,
- Të hyrat nga projekti ODYSSEE-MURE,
- Qiranë e objektit solar dhe
- Shitjen e shërbimeve dhe participimet e tjera.

Ky sqarim tregon qartë se dallimi reflekton **realizimin faktik të të hyrave nga burime të ndryshme** dhe korrigjimet nga vitet paraprake.

Daljet:

Ndryshimet në tabelën e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit për vitin fiskal 2025 janë rezultat i këtyre vendimeve të Qeverisë:

VQ-Nr. 22/269, Datë: 19.09.2025: Ndarja e mjeteve prej 615,879.28 Euro për zbatimin e masës 4 dhe 5 të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik ne kuadër te masës 3.7-Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të pakos së Ringjalljes Ekonomike.

VQ-Nr. 01/281 dhe VQ-Nr. 03/261 të datës 24 dhjetor 2025 për kursim dhe ndarje,

Nr. 01/279, Datë: 15.12.2025: për kursim dhe ndarje,

Nr. 01/282, datë: 26.12.2025: Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore në vlerë prej 2,320,332€ (dy milionë e treqind e njëzet mijë e treqind e tridhjetedy eurosh), deri në 25% të ndarjeve buxhetore të ndikuara negativisht në totalin e kategorive të shpenzimeve: "Mallra dhe Shërbime", "Shpenzime Komunale", si dhe "Subvencione dhe Transfere", me qëllim të ofrimit të përkrahjes financiare për Minierën e Trepçës.

VQ-Nr. -04/282, datë: 26.12.2025: për kursim dhe ndarje,

## Shënimi 2  Paga dhe shtesa

| Përshkrimi | Gjithsej Pagesat | FH | KI | FZHM | GQ | THV | THD | GPD | Buxheti Final | Ndryshimi Buxheti - Pagesat | 2024 | 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| PAGA NETO | 1,190 | | | | 1,190 | | | | 1,190 | | 1,103 | 1,166 |
| TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE | 93 | | | | 93 | | | | 93 | | 91 | 86 |
| KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI | 74 | | | | 74 | | | | 74 | | 70 | 66 |
| PËRVOJA E PUNËS | 65 | | | | 65 | | | | 65 | | 58 | - |
| KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI | 74 | | | | 74 | | | | 74 | | 70 | 66 |
| SHTESA PËR KUSHTE TË TREGUT TË PUNËS | 13 | | | | 13 | | | | 13 | | 12 | - |
| SHTESA PËR PUNËN PA ORAR TË PARACAKTUAR | 20 | | | | 20 | | | | 20 | | - | - |
| SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS | 5 | | | | 5 | | | | 5 | | 20 | - |
| KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNË | 5 | | | | 5 | | | | 5 | | 28 | - |
| FUNKSIONET SHTESË | 0 | | | | 0 | | | | 0 | | 1 | - |
| SHTESAT TRANZITORE | 7 | | | | 7 | | | | 7 | | 11 | - |
| Shtesa e përformancës | - | | | | - | | | | - | | 2 | - |
| **Paga dhe shtesa** | 1,547 | - | - | - | 1,547 | - | - | - | 1,547 | - | 1,468 | 1,384 |

**Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:**

Buxheti fillestar për paga dhe mëditje për vitin 2025 ishte 1,776,496 Euro, ndërsa buxheti final, në SIMFK, është 1,546,700.42 Euro. Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025, në krahasim me alokimet në SIMFK, është 1,546,700.42 Euro, që përkthehet në 100%.

## Shënimi 3 Mallra dhe shërbime

| Përshkrimi | Gjithsej Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | FZHM € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Buxheti Final € '000 | Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000 | 2024 -1 € '000 | 2023 -2 € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit | 4 | | | | 4 | | | | | | 2 | 16 |
| Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit | 22 | | | | 22 | | | | | | 29 | 8 |
| Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit | 9 | | | | 9 | | | | | | 8 | 9 |
| Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit | 14 | | | | 14 | | | | | | 18 | 29 |
| Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit | 4 | | | | 4 | | | | | | 4 | 30 |
| Interneti | 61 | | | | 61 | | | | | | 4 | 3 |
| Telefonia mobile | 11 | | | | 11 | | | | | | 16 | 16 |
| Shpenzimet postare | 0 | | | | 0 | | | | | | 1 | - |
| Shërbimet e arsimit trajnimit | 0 | | | | 0 | | | | | | 1,102 | 726 |
| Shërbime këshilldhënësë dhe profesionale | 711 | | 711 | | - | | | | | | 344 | 263 |
| Sherbimet e shtypjes/printimit | 12 | | | | 12 | | | | | | 20 | 14 |
| Sherbimet kontraktuese tjera | 251 | | | | 251 | | | | | | 957 | 565 |
| Sherbime teknike | 2 | | | | 2 | | | | | | 2 | 6 |
| shpenzimet e anëtarësimit | 127 | | | | 127 | | | | | | 303 | 20 |
| Mobiljet | - | | | | - | | | | | | 4 | - |
| Kompjuteret | 34 | | | | 34 | | | | | | 41 | - |
| Pajisje tjera | 7 | | | | 7 | | | | | | 21 | 5 |
| Furnizim per zyre | 2 | | | | 2 | | | | | | 11 | 6 |
| Furnizim me ushqim dhe pije ( jo dreka zyrtare) | 42 | | | | 42 | | | | | | 43 | 39 |
| Derivate per automjete, gjenerator dhe makineri | 16 | | | | 16 | | | | | | 26 | 25 |
| Regjistrim, sigurim dhe taksa komunale per automjeteve | 8 | | | | 8 | | | | | | 9 | 10 |
| Sigurim i ndertesave tjera | 83 | | | | 83 | | | | | | 49 | 50 |
| mirembajtje dhe riparim I automjeteve | 15 | | | | 15 | | | | | | 29 | 30 |
| mirembajtje e ndertesave | 41 | | | | 41 | | | | | | 28 | 24 |
| Mirembajtje e tekonlogjise informative | 0 | | | | 0 | | | | | | 2 | - |
| mirembajtje e mobileve dhe pajisjeve | 0 | | | | 0 | | | | | | 1 | - |
| Qiraja | 5 | | | | 5 | | | | | | 26 | 14 |
| Sherbimet per informim publik | - | | | | - | | | | | | - | 90 |
| Botimet dhe publikimet | 0 | | | | 0 | | | | | | 1 | 7 |
| sherbimet e perfaqesimit brenda vendit | 5 | | | | 5 | | | | | | 7 | 9 |
| | 1,487 | - | 711 | - | 776 | - | - | - | 5,715 | 4,228 | 3,107 | 2,014 |

## Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Buxheti fillestar për kategorinë Mallra dhe Shërbime për vitin 2025 ishte planifikuar në vlerën 6,782,034 Euro, i ndarë sipas fondeve burimore si vijon: Fondi Burimor 10 në vlerën 2,012,466 Euro dhe Fondi Burimor 04 në vlerën 4,769,568 Euro.

Buxheti final ne SIMFK për këtë kategori për vitin 2025 është 5,715,328.94 Euro, nga të cilat 945,760.84 Euro i takojnë Fondit Burimor 10, ndërsa 4,769,568.10 Euro Fondit Burimor 04. Reduktimi i buxhetit krahasuar me planifikimin fillestar lidhet kryesisht me rishikimet/harmonizimet buxhetore gjatë vitit.

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar–Dhjetor 2025 është 1,486,863.04 Euro ose 26% nga buxheti i alokuar në SIMFK. Sipas fondeve burimore, niveli i realizimit paraqitet si ne vijim: Fondi Burimor 10 ka shënuar realizim në nivelin 82%, ndërsa Fondi Burimor 04 vetëm 15%.

Mosrealizimi i buxhetit në Fondin Burimor 04 është kryesisht rezultat i mos fillimit të implementimit të disa projekteve të planifikuara, të cilat financohen përmes klauzolës së investimeve:

1. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujerave të zeza – Ferizaj,
2. Impianti për Trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë,
3. Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza Mitrovicë.

Këto projekte, të cilat parashihej të zbatoheshin nga ndërmarrjet publike, kanë pësuar vonesa në fillim të realizimit, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në mos shpenzimin e mjeteve të planifikuara. Si pasojë, niveli i realizimit të buxhetit për këtë fond ka qenë dukshëm më i ulët krahasuar me planifikimin fillestar.

## Shënimi 4 Shpenzime komunale

| Përshkrimi | 2025 Gjithsej Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | FZHM € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Buxheti Final € '000 | Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000 | 2024 € '000 | 2023 € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Energjia elektrike | 4 | | | | 4 | | | | | | 5 | 4 |
| Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit | 0 | | | | 0 | | | | | | 1 | 0 |
| Ngrohja qendrore | 1 | | | | 1 | | | | | | 5 | 1 |
| Telefonia fikse | 7 | | | | 7 | | | | | | 6 | 8 |
| **Shpenzime komunale** | 13 | - | - | - | 13 | - | - | - | 17 | 4 | 17 | 13 |

**Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:**

Buxheti fillestar i planifikuar për kategorinë e **shërbimeve komunale** për vitin 2025 ishte **23,130 Euro**, ndërsa pas rishikimeve buxhetore gjatë vitit, buxheti final është reduktuar në **17,350 Euro**.

Nga buxheti final i alokuar, gjatë vitit është realizuar shpenzim në vlerën **12,593.42 Euro**, që përfaqëson **73% të buxhetit të miratuar** për këtë kategori.

Reduktimi i buxhetit nga vlera fillestare në atë finale ka ardhur si rezultat i **deklarimit të kursimeve buxhetore nga Ministria e Ekonomisë në fund të vitit fiskal**. Këto kursime kanë ndikuar në rishikimin e planifikimit fillestar dhe në uljen e fondeve të alokuara, duke përshtatur buxhetin final me nivelin real të shpenzimeve dhe nevojave të evidentuara gjatë vitit.

## Shënimi 5 Subvencione dhe transfere

| | 2025 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | | | | | | | | Buxheti | Ndryshimi | 2024 -1 | 2023 -2 |
| Përshkrimi | Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | FZHM € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Final € '000 | Buxheti - Pagesat € '000 | € '000 | € '000 |
| Subvencione për entitetet publike | 10,082 | | | | 10,082 | | | | | | 24,542 | 44,079 |
| Subvencione për entitetet jopublike | 12,644 | | | | 12,644 | | | | | | 21,665 | 6,912 |
| | 22,726 | - | - | - | 22,726 | - | - | - | 23,976 | 1,250 | 46,207 | 50,991 |

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**

Buxheti fillestar i ndarë për kategorinë **Subvencione dhe Transferime** për vitin 2025 ishte **22,903,634 Euro**. Pas ndryshimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, buxheti final në fund të vitit 2025 ka arritur në **23,976,239 Euro**.

Nga buxheti final i alokuar, shpenzimet e realizuara kanë arritur në **22,726,419.72 Euro**, që përfaqëson **95% të buxhetit të miratuar**, duke reflektuar një nivel të lartë të realizimit për këtë kategori shpenzimesh.

Ndryshimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final në këtë kategori ka ardhur si rezultat i **vendimeve të Qeverisë**, të cilat janë të shpalosura dhe të detajuara në **Tabelën – Neni 14.6: Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit**.

Rritja e buxhetit për kategorinë e subvencioneve është rezultat i **vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK)** për financimin e **Masës 4 dhe Masës 5**, si dhe **mbështetjes financiare për ndërmarrjen publike Trepça Sh.A.**, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të shpenzimeve në këtë kategori.

## Shënimi 6 Shpenzime kapitale

| Përshkrimi | Gjithsej Pagesat € '000 | FH € '000 | KI € '000 | FZHM € '000 | GQ € '000 | THV € '000 | THD € '000 | GPD € '000 | Buxheti Final € '000 | Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000 | 2024 € '000 | 2023 € '000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërtesat administrative dhe afariste | - | | | | | | | | | | | |
| Kompjuter | 199.8 | | | | 200 | | | | | | 1,932 | 2,755 |
| Pajisjet e tjera të teknologjisë informative dhe te k | 647.8 | | | | 648 | | | | | | 9 | |
| Rrjetet e kanalizimit | 2,390.0 | | 2,390 | | | | | | | | 3,295 | 500 |
| Softueret | 70.3 | | | | 70 | | | | | | | |
| **Shpenzime Kapitale** | 3,308 | - | 2,390 | - | 918 | - | - | - | 6,950 | 8,800 | 5,236 | 3,255 |

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**

Buxheti fillestar i ndarë për kategorinë **Pasuri jo-financiare** për vitin 2025 ishte **2,850,000 Euro** nga **Fondi Burimor 10 (FB 10)**, ndërsa për **Fondi Burimor 06 (FB 06)**, përmes klauzolës së investimeve, buxheti i planifikuar ishte **5,950,000 Euro**.

Sipas të dhënave të regjistruara në **SIMFK**, buxheti final i miratuar për Pasuritë jo-financiare për vitin 2025 ka qenë **6,949,834.00 Euro**, pas rishikimeve buxhetore gjatë vitit.

Realizimi i buxhetit sipas fondeve burimore paraqitet si vijon:

- **FB 06**: Alokuar **5,950,000.00**, Shpenzime të realizuara në vlerën **2,390,000.00 Euro**, që përfaqësojnë **40% të buxhetit të alokuar**;
- **FB 10**: Alokuar **999,834.00**, Shpenzime të realizuara në vlerën **917,823.60 Euro**, që përfaqësojnë **92% të buxhetit të alokuar**.

Dallimi i ndjeshëm në nivelin e realizimit ndërmjet fondeve burimore lidhet kryesisht me dinamikën e zbatimit të projekteve investive të financuara nga **FB 06**, të cilat kanë pësuar vonesa në fazat e implementimit, krahasuar me projektet e financuara nga **FB 10**, të cilat kanë pasur nivel më të lartë të realizimit gjatë vitit raportues.

## Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

| Përshkrimi | Shënime | 2025 € '000 | 2024 € '000 | 2023 € '000 | 2025 | % e ndryshimit nga 2024 -1 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Te hyrat nga viti i kalura | | 183 | 16,349 | - | 54% | 99% |
| KOMPENSIMI I DËMEVE NGA KOMPENSIMI I SIGURIMIT | | - | - | 23 | | |
| PRANIMET NGA TARIFAT PËR VENDIMET GJYQËSORE/PËRMB | | - | - | 88 | | |
| QIRAJA NGA PRONA PUBLIKE | | 126 | 126 | - | 37% | 1% |
| SHITJA E SHËRBIMEVE | | 4 | 2 | 7 | 1% | 0% |
| PARTICIPIMET | | 26 | 1 | - | 8% | 0% |
| Pranimet tjera | | - | - | 4 | | |
| **Gjithsej** | | **338** | **16,477** | **121** | **100%** | **100%** |

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**

Gjatë vitit fiskal 2025, në kategorinë **të hyrave jo-tatimore** janë realizuar të ardhura nga burime të ndryshme:

**Te hyrat nga viti I kaluar**: Kthimi i mjeteve financiare të paguara gabimisht gjatë vitit 2024 në shumën **183,062.43 €**, regjistruar sipas nenit 41.2 të LMFPP.

**Participimet**: Të hyrat nga projekti **ODYSSEE-MURE** në vlerën **25,500.00 €**, realizuar përmes kontratës nënkontraktimi me Fraunhofer.

**Qiraja nga prona publike: Qira e objektit solar në Kramovik**, me dy pagesa: 125,643.50 € dhe 257.00 €.

Të hyrat nga **shitja e shërbimeve**, realizuar nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Inspektorati i Energjisë.

**Sqarim mbi dallimin me projeksionin:**
Vlera totale e realizuar të hyrash jo-tatimore për vitin 2025 është më e madhe se buxheti fillestar/projeksioni i Ministrisë së Financave. Ky dallim reflekton arkëtimin e plotë të të hyrave, duke përfshirë korrigjimet nga viti i kaluar dhe të hyrat e paplanifikuara

## Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

| Kategoria ekonomike | 2025<br>€ '000 | 2024 -1<br>€ '000 | 2023 -2<br>€ '000 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe shtesa | | | |
| Mallra dhe shërbime | 712 | | |
| Shpenzime komunale | | | |
| Transfere dhe subvencione | | | |
| Shpenzime kapitale | 2,390 | | |
| **Gjithsej pagesat nga palët e treta** | **3,102** | **0** | **0** |

*Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1:*

Pagesat nga palët e treta lidhen me realizimin e projekteve të financuara përmes **klauzolës së investimeve**, ku **Ministria e Ekonomisë** vepron në cilësinë e **ndërmjetësuesit (autoritet zbatues)** për procedimin e pagesave. Këto pagesa realizohen në bazë të **kontratave të nënshkruara ndërmjet njësive zbatuese të projekteve dhe operatorëve ekonomik**, pas pranimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës të miratuar.

Në përputhje me kornizën ligjore dhe marrëveshjet përkatëse, këto transaksione regjistrohen në **SIMFK** me mënyrën e pagesës **"Pagesa Direkte"**.

Gjatë vitit fiskal **2025** janë regjistruar **tri (3) fatura**, të cilat i përkasin projektit **Pristina Waste Water Treatment Project**, me një vlerë totale prej **711,124.74 Euro**.

Njëra nga këto fatura, në vlerë prej **182,870.43 Euro**, ishte regjistruar ne SIMFK gjatë vitit **2024**, por rezultoj të jetë regjistruar gabimisht si **pagesë ndërkombëtare**, në vend se si **pagesë direkte**. Gjatë vitit fiskal **2025**, këto mjete janë kthyer nga operatori ekonomik në **llogarinë e Thesarit** dhe janë regjistruar në mënyrën e duhur në **SIMFK**, në përputhje me rregullat dhe procedurat e raportimit financiar.

Dy (2) faturat e tjera janë regjistruar gjatë vitit **2025** në kuadër projektit "Wastewater Treatment Plant in Gjilan" si vijon:

- faturë në vlerë prej **119,745 Euro**, e regjistruar në kategorinë Mallra dhe Sherbime **Shërbime konsulente**; ne Janar te vitit 2026 nga NP-Hidromorava eshte kërkuar anulimi i landes, arsyeja për këtë anulim është kërkesa e konsulentit **LIV (Operatori ekonomik)**, e cila bazohet në praktikën që në Turqi **viti i lëshimit të faturës duhet të përputhet me vitin e pagesës**.

- faturë në vlerë prej 2,390,000 Euro, e regjistruar në kategorinë e shpenzimeve kapitale, e cila përfaqëson pagesën e avancit, bazuar në kontratën për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit.

## Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

| Kategoria Ekonomike | Kategoria ekonomike | 2025 | | 2024-1 | | 2023-2 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | < 30 ditë | > 30 ditë | < 30 ditë | > 30 ditë | < 30 ditë | > 30 ditë |
| 11 | Paga dhe shtesa | | | | | | |
| 13 | Mallra dhe shërbime | 7,892.19 | | 17,200.21 | | 20,030.59 | |
| 14 | Shpenzime komunale | - | | 452.92 | | 1,281.84 | |
| 20 | Transfere dhe subvencione | 6,950.00 | | - | | 335,281.44 | |
| 30 | Shpenzime kapitale | - | | 52,409.70 | | - | |
| **Gjithsej** | | **14,842.19** | 0 | **70,062.83** | - | **356,593.87** | 0 |

***Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 3***

Të gjitha obligimet e bartura nga viti 2025 në vitin 2026 kanë ardhur si rezultat i mbylljes/përfundimit të vitit fiskal dhe kryesisht janë fatura të muajit Dhjetor të cilat janë pranuar pas datës 24 dhjetor 2024.

| Data e pranimit te fatures | Numri i faturës | Kodi ekonomik | Afati i pagesës | Furnitori | Përshkrimi | Arsyeja e mospagesës | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17.12.2025 | 32-210-001-25 | 13620 | Janar 2026 | RESTAURANT RRON | USHQIM DHE PIJE | Mbyllja e vitit fiskal | 5,950.00 |
| 18.11.2025 | 123K/25 | 14010 | Janar 2026 | EKO ENG SH,P,K | MIREMBAJTJE TE VETURAVE | Mbyllja e vitit fiskal | 30.00 |
| 03.12.2025 | 041207003538/2481 | 13320 | Janar 2026 | VALA | TELEFONI MOBILE | Mbyllja e vitit fiskal | 759.99 |
| 19.12.2025 | 587/25 | 14010 | Janar 2026 | NTP MIRI | MIREMBAJTJE TE VETURAV | Mbyllja e vitit fiskal | 828.20 |
| 19.12.2025 | 580/25 | 14010 | Janar 2026 | NTP MIRI | MIREMBAJTJE TE VETURAV | Mbyllja e vitit fiskal | 324.00 |
| 23.12.2025 | 4657 | 21200 | Janar 2026 | Foundation House | SUBVENCIONE | Mbyllja e vitit fiskal | 6,950.00 |
| **Gjithsej** | | | | | | | **14,842.19** |

## Neni 18 Detyrimet kontingjente

| Kategoria ekonomike | Kategoritë ekonomike | 2025 | 2024-1 | 2023-2 |
|---|---|---|---|---|
| 11 | Paga dhe shtesa | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 13 | Mallra dhe shërbime | 199,368.10 | 30,231.00 | 1,580,748.86 |
| 14 | Shpenzimet komunale | | | |
| 20 | Subvencione dhe Transfere | | | |
| 30 | Shpenzimet kapitale | | | |
| Gjithsej | | **209,368.10** | **40,231.00** | **1,590,748.86** |

*Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 4*

| Nr | Departamenti/ Drejtoria | Paditësi/Propozuesi | Numri i lëndës | Përshkrimi i Detyrimit Kontigjent | Arsyeja e shkaktuar për detyrimin kontigjent | Vlera e Detyrimit Kontigjent |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ASH-04-2021-1046 | Departamenti Administrativ | Epir Qiriqi | A.nr.321/20 | Anulim vendimi | | - |
| ASH-04-2021-1077 | Gjykata Themelore e Gjakovës | Frrok Hajdari | C.nr.583/21 | Kompensim Demi | | 96,374.60 |
| ASH-04-2021-1080 | Gjykata | Ic consulenten | P.nr.449/21 | Propozim per permbarim | | 11,100.00 |
| ASH-04-2021-1899 | Gjykata Themelore e Prishtines | Mbrojtja dhe siguria, KEK | C.nr.2851/21 | Kompesim Demi | | - |
| ASH-04-2022-1323 | Gjykata Themelore e Prishtines | Epir Qeriqi | C.nr.324/22 | Anulim Vendimi | | 10,000.00 |
| ASH-04-2022-2364 | Departamenti Administrativ | Epir Qeriqi | A.nr.1639/21 | Anulim Vendimi | | - |
| ASH-04-2022-2845 | Departamenti Administrativ | Rrustem Loshi | A.nr.1902/22 | Anulim Vendimi | | - |
| ASH-04-2023-1878 | Departamenti Administrativ | Epir Qeriqi | A.nr.2144/22 | Anulim Vendimi | | - |
| ASH-04-2023-4082 | Departamenti Administrativ | Nol Zekolli | A.nr.2805/22 | Anulim Vendimi | | - |
| DÇL-04-2014-3062 | Departamenti Administrativ | Instituti per Studime te avancuara | A.nr.750/13 | Anulim Vendimi | | - |
| DÇL-04-2015-1016 | Gjykata | Tribuna Shqiptare | | Propozim per permbarim | | - |
| DÇL-04-2015-1792 | Gjykata Themelore e Gjakovës | Frrok Hajdari | C.nr 154/15 | Kompensim demi | | - |
| DÇL-04-2015-2287 | Departamenti Ekonomik | Tricom | E.nr 472/15 | Borxh | | 1,131.00 |
| DÇL-04-2015-2586 | Departamenti Administrativ | Vitech | A.nr 2112/15 | Anulim vendimi | | - |
| DÇL-04-2015-820 | Gjykata Themelore Prishtine | Maliq Berisha | C.nr 2193/13 | Kompensim Demi | | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| DÇL-04-2016-1323 | Gjykata Themelore Prishtine - Dega Podujeve | Jahir Gashi | C.nr 237/12 | Kompensim Demi | | - |
| DÇL-04-2016-2325 | Departamenti Administrativ | Instituti per studime te avancuara Gap | A.nr 750/13 | Anulim vendimi | | - |
| DÇL-04-2017-1357 | Gjykata Themelore e Gjakovës | Dren Bakalli-Aeroporti i Gjakoves | C.nr 121/17 | Fitimi I humbur | | 5,000.00 |
| DÇL-04-2017-1809 | Departamenti Administrativ | Euro Projekt | A.nr 619/14 | Anulim vendimi | | - |
| DÇL-04-2017-2026 | Gjykata Themelore e Mitrovices | Burhan Bajra, Infrakos | C.nr.474/17 | Vertetim Pronesie | | 3,000.00 |
| DÇL-04-2019-576 | Departamenti Administrativ | Balkan Green Foundation | A.nr 318/17 | Anulim vendimi | | - |
| DÇL-04-2020-196 | Gjykata Themelore e Gjakovës | Frrok Hajdari | C.nr.416/19 | Shpronesim | | - |
| DÇL-04-2020-2029 | Gjykata Komerciale | Dardafon | P.nr 2670/20 | Propozim per permbarim | | 248.54 |
| ASH-04-2024-7148 | Gjykata Themelore e Prishtines | Ramadan Sejdiu | C.nr.5151/22 | Anulim vendimi | | - |
| ASH-04-2024-2380 | Gjykata Komerciale | Arjeta Group | Ka.nr.684/22 | Anulim vendimi | | - |
| ASH-04-2024-3485 | Gjykata Themelore e Prishtinës | Pleurat Nuza | C.nr.994/22 | Kompensim i mjeteve shtesë | | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KA.nr.280/25 | Gjykata Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative | Grupi i Operatorëve Ekonomik "Saves Enerji A.S | KA.nr.280/25 | Masë të Përkohshme të Sigurisë | | - |
| KA.nr.1138/22 | Gjykata Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative | "Armakos" sh.p.k | KA.nr.1138/22 | Anulim vendimi | | 4,064.60 |
| Nr. 1862/2923 | Gjykata Themelore e Prishtines - Departamenti Administrativ | Xhevdet Tahiri | Nr. 1862/2923 | Anulimi i pjeserishem i Vendimit të QRK Nr.18/162 | Lenda eshte akoma ne proces. Ministria ne shkresën e datës 03.04.2024 Nr. Prot. 3400 ka dërguar te gjitha shkresat dhe provat qe posedon ne Avokaturën Shtetërore. | - |
| Nr. 04058206 | Gjykatës Themelore në Ferizaj | Gëzim (Nehat) Topalli | Nr. 04058206 | Dëmshpërblimi jo material dhe material | Ministria e Ekonomisë ka dërguar shkresë Avokaturës Shtetërore lidhur me çështjen; Nr. 2023: 060617, ku sqarohen përgjegjësitë e saj administrative, të cilat do t'i shërbejnë si prova për të vërtetuar se Ministria e Ekonomisë nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me shpërthimin e bombolës së gazit në restorantin "Steak House" në lagjen "The Village" Ferizaj me datë 05.01.2021. | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. 04058206 | Gjykatës Themelore në Ferizaj | Gëzim (Nehat) Topalli | Nr. 04058206 | Dëmshpërblimi jo material dhe material | Ministria e Ekonomisë ka dërguar shkresë Avokaturës Shtetërore lidhur me çështjen; Nr. 2023: 060617, ku sqarohen përgjegjësitë e saj administrative, të cilat do t'i shërbejnë si prova për të vërtetuar se Ministria e Ekonomisë nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me shpërthimin e bombolës së gazit në restorantin "Steak House" në lagjen "The Village" Ferizaj me datë 05.01.2021. | - |
| C.nr. 837/2023 | Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec | Arif Fetahaj | C.nr. 837/2023 | Vertetim Pronesie | Ministria ka dërguar te gjitha shkresat dhe provat lidhur me lenden dhe ja ka përcjellur Avokaturës Shtetërore për përgatitjen e përgjigjes ne padi, Nr.Prot. 5833, date 02.10.2024. | 4,950.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| C.nr.4901/20 | Gjykata Themelore ne Prishtine | Faruk Hajrizi, Gjelosh Vataj, Mehdi Pllashniku, Izet Ibrahimi, Fllanza Beqiri-Hoxha. | C.nr.4901 /20 | Anulimin e vendimit dhe kompensimin e pagave | **Faruk Hajrizi**: Pagat shumën prej 6.489.45 €, né emer pagave stimuluese shumen prej 3.244.73 € ne shumën e pergjithshme prej 9.734.24 € me kamate vjetore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit te padise 26.05.2020 e deri ne pagese definitive, ne emer tê paditesit ne trustin pensional te Kosoves shumën prej 658.50€ dhe nê emer te tatimit ne page ne Administraten Tatimore te Kosoves shumën prej 1.081.58 –<br>**Gjelosh Vataj** ne emer te pagave shumën prej 5.233.46 €. ne emer pagave stimuluese shumën prej 2.616.73 € ne shumen e pergiithshme prej 7.850.19 € me kamaté jetore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit te padise 26.05.2020 e deri ne pagese definitive. né emer te paditesit ne trustin pensional te Kosoves shumën prej 319.08 € dhe ne emer te tatimit nê page ne Administraten Tatimore tê Kosoves shumën prej 872.25 €.<br>**Mehdi Pllashniku** nga Prishtina të ia paguaj né emer pagave shumën prej 5.078.70 €, ne emer pagave stimuluese shumën prej 2,539,35 € ne shumën e pergjithshme prej 7,618.05 € me kamate vjetore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit tę padise 26.05.2020 e deri né pagese definitive, né emer tę paditesit ne trustin pensional te Kosovës shumën prej 445.50€ dhe ne emèr te tatimit ne page ne Administratën Tatimore te Kosovës shumën prej 846.45 €.<br>**Izet Ibrahimi** nga Gllogoc, fia paguaj né emer pagave shumen prej 5,925.15 €, né emër pagave stimuluese shumen prej 2,962,58 € ne shumen e pergjithshme prej 8,887.73 € me kamate vjetore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit te padise 26.05.2020 e deri ne pagese definitive, ne emer te paditesit ne trustin pensional te Kosovës shumën prej 519.75€ dhe ne emer te tatimit né pagé ne Administratén Tatimore te Kosoves shumen prej 987.53 €.<br>**Flanza Beqiri** - Hoxha t'ia paguaj ne emer pagave shumën prej 6,541.03 €. nę emér pagave stimuluese shumën prej 3.270.52 € ne | 50,799.36 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| C.nr.718/2023 | Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec | Sadri Fetahaj | C.nr.718/2023 | Vërtetimin e pronësisë në bazë të ndërtimit dhe parashkrimit fitues. | Ministria e Ekonomisë sipas shkresës Nr.Prot.5862, datë 04.10.2024 ka dërguar ne Avokaturën Shtetërore te gjitha shkresat dhe provat relevante me qellim te përgatitjes se përgjigjes ne Padi. | 4,950.00 |
| nr. 1299/2023 | Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative | Avni Ramadani | nr. 1299/2023 | Baze anulimin e Aktvendimit kontestues | Ministria e Ekonomisë sipas shkresës Nr. Prot. 5888 dat. 10.10.2024 ka dërguar ne Avokaturën Shtetërore te gjitha shkresat dhe provat relevante me qellim te përgatitjes se përgjigjes ne Padi. | - |
| C.nr.3890/20 | Gjykata Themelore e Prishtines - Deparatamenti i Pergjithshem | Xhevat Morina | C.nr.3890/20 | Kompensim Demi | | 10,000.00 |
| nr.3421/24 | Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative | Mete Begaj | nr.3421/24 | Anulimi i vendimit | Ministria e Ekonomisë sipas kërkesës të datës 20.02.2025, nga Avokatura Shtetërore ia përcjell te gjithë lëndën të njëjtës, për përgatitjen e përgjigjes në padi | 1,750.00 |
| C.nr.3923/23 | Gjykata Themelore ne Prishtine - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni për çështje Civile | Alban Zylfaj | C.nr.3923/23 | Anulimin e Vendimit | | 1,000.00 |
| K.DSH.SH.II nr.1248/25 | Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dyte | "Saves Enerji A.S&Turk Ytong Sanayi A.S&Artibir Enerji A.S&Prishtina Energy SHPK&Data System LLC i emëruar grupi i operatoreve ekonomik "One Era" | K.DSH.SH.II nr.1248/25 | Anulim i Vendimit/caktimit te Masë të Përkohshme të Sigurisë | | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| C.nr. 286/20 | Gjykata Themelore e Gjakovës | Miodrag Tatar | C.nr. 286/20 | Kthimi në posedim i palujtëshmëris dhe kompensimi për shkak të pasurimit të pa bazë. | | - |
| C.nr.1093/22 | Gjykata Themelore e Prishtinës- Departamenti i Pergjithshem | Valbona Thaqi | C.nr.1093 /22 | Anulim Vendimi | | - |
| C.nr.2459/22 | Gjykata Themelore e Prishtinës - Departamenti i Pergjithshem | Fahri Blakaj | C.nr.2459 /22 | Diskriminimi | | 5,000.00 |
| KA nr.280/25 | Gjykatës Komerciale - Departamenti për Cështje Administrative | Saves Enerji A.S&Turk Ytong Sanayi A.S&Artibir Enerji A.S&Prishtina Energy SHPK&Data System LLC i emëruar grupi i operatoreve ekonomik "One Era | KA nr.280/25 | AnulimVendimi | Me vendimin e shkallës së dyt të Gjykatës Komerciale të Kosovës është refuzuar Ankesa e Paditsit Saves Enerji A.S&Turk Ytong Sanayi A.S&Artibir Enerji A.S&Prishtina Energy SHPK&Data System LLC i emëruar grupi i operatoreve ekonomik "One Era, Ndersa eshte vertetuar Vendim KA nr.280/25 i Gjykatës i shkallës së par – Departamenti për Cështje Administrative | - |

Vlera prej 96,375.00 euro rrjedh nga parashtresa për precizim të padisë e paditësit, e datës 01.11.2018, për pretendim financiar për shkak të shfrytëzimit të paluajtshmërisë. Megjithatë, për shkak se bëhej fjalë për një pretendim dhe duke qenë se lënda ishte në trajtim nga Avokatura Shtetërore, vlera e kontestit nuk ishte ndryshuar në listën e detyrimeve kontingjente, duke mbetur e evidentuar në shumën 5,000.00 euro.

Avokatura Shtetërore ka ushtruar Përgjigje në Padi me datë 04.06.2021, duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe duke konstatuar se pala e paditur nuk ka hyrë në posedim të ligjshëm të paluajtshmërisë. Sipas komunikimeve me Avokatin Shtetëror të caktuar për këtë lëndë, procedura gjyqësore ka qenë në fazën fillestare, ndërsa veprimet e mëtejme kanë qenë në pritje nga gjykata.

Ministria e Ekonomisë (Departamenti Ligjor) nuk ka qenë e njoftuar në kohë lidhur me Vendimin e Gjykatës, pasi i njëjti nuk është pranuar përmes arkivit zyrtar të Ministrisë, ndonëse në këtë vendim figuron vlera e kontestit prej 96,375.00 euro.

Pas mbajtjes së një takimi urgjent me Avokaturën Shtetërore, Ministria është njoftuar me Vendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, me shenjë C.nr.416/19, të datës 29.12.2022, i cili është pranuar nga Avokatura Shtetërore më 19.01.2023 dhe i cili është ankimuar brenda afatit ligjor në të njëjtën datë.

Ministria është njoftuar zyrtarisht për ekzistimin e këtij vendimi dhe për vlerën përkatëse të kontestit vetëm më 02.04.2025, pas një takimi urgjent me Avokatin Shtetëror përgjegjës për përfaqësimin e kësaj lënde.

Aktualisht, kjo çështje juridiko-civile ndodhet në fazën e ankimimit. Mosnjoftimi me kohë për ekzistimin e Vendimit të Gjykatës ka pamundësuar përfshirjen e kësaj vlere në listën paraprake të detyrimeve kontingjente për vitet paraprake.

Si rrjedhojë, vlera prej **96,375.00 euro** është përfshirë në **listën e detyrimeve kontingjente për vitin 2025**.

## Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

### Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

| Klasifikimi i pasurive | 2025 | 2024-1 | 2023-2 |
|---|---|---|---|
| Ndërtesa | 451,710.46 | 468,268.78 | 78,264.00 |
| Toka | 1,000.00 | 1,000.00 | 1,000.00 |
| Pajisjet | 152,951.87 | 215,817.16 | 270,667.00 |
| Kapital tjeter | - | - | 15,063.00 |
| Pasuri te pa-prekshme | 166,416.65 | 225,155.57 | 283,894.00 |
| Struktura tjera | 154,711.38 | 161,536.86 | 168,362.00 |
| Investimet ne vijim | 9,914,572.08 | 8,356,290.83 | 4,383,805.00 |
| Automjetet | 15,614.43 | 24,039.67 | 33,780.00 |
| Kompjuter | 12,101.69 | 43,007.07 | 74,210.00 |
| Pajisje te teknologjise informative | 116,015.92 | 9,644.32 | 679,316.00 |
| Softwer | 15,127.19 | - | - |
| **Gjithsej** | **11,000,221.67** | **9,504,760.26** | **5,988,361.00** |

*Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 5*

Vlera e pasurisë kapitale në shumë prej **2,117,418.18 Euro** në kuadër të programit **43800 – Departamenti i Energjisë dhe vlera 4,287,353.90 ne AKEE** është e evidentuar si **investim në vijim**. Projekti përkatës është realizuar, kontrata me operatorin ka përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve.

Megjithatë, në regjistrin e pasurive kjo vlerë vazhdon të figurojë si investim në vijim, pasi procesi i bartjes së pasurisë te institucionet përfituese të projektit ende nuk është përfunduar. Nga ana e Ministrisë së Ekonomisë janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për bartjen e pasurisë, mirëpo nga disa institucione përfituese ende nuk kemi pranuar marrëveshjen e nënshkruar nga ana e tyre.

Si rezultat i mos-përmbylljes së procedures s bartjes së pasurive, përkatësisht mos-nënshkrimit të marrëveshjeve nga institucionet përfituese, investimi në vijim nuk ka mundur të mbyllet dhe të regjistrohet si pasuri e përfunduar në pasqyrat financiare.

## Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

| Klasifikimi i pasurive | 2025 | 2024-1 | 2023-2 |
|---|---|---|---|
| Pajisjet dhe mobiljet | 1,405,789.00 | 601,827.79 | 47,965.05 |
| **Gjithsej** | **1,405,789.00** | **601,827.79** | **47,965.05** |

*Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 6:*

Rritja e vlerës se pasurisë jo kapitale ( me vlerë nën 1,000 Euro) në krahasim me vitet e kaluara është rezultat i investimit nga projekti KODE, financimi në Universitetet Publike dhe 243 shkolla të ciklit para-universitar.

## Neni 19.3.3 Stoqet

| Klasifikimi i pasurive | 2024 | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| Stoqet | 84,467.71 | 62,268.91 | 34,107.61 |
| **Gjithsej** | **84,467.71** | **62,268.91** | **34,107.61** |

*Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 7:*

Rritja e stoqeve ne vitin 2025 krahasuar me vitet tjera ka ardhur si rezultat i blerjes së 40 Kompjuterëve për nevoja të ME-së.

## Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara

| Data e lëshimit | ID e furnitorit te Zyrtarit | Nr i kuponit të sl | Arsyeja | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| 16.09.2025 | A213-514062 | 2025-372750 | Gabim ne kodin e programit | 225.00 |
| 16.09.2025 | A213-514066 | 2025-372685 | Gabim ne kodin e programit | 451.20 |
| **Gjithsej** | | | | 676.20 |

<u>**Shpalos me poshtë në detaje shënimet nga tabela:**</u>

- **shpalosje e avanceve te hapura ose te bartura nga vitet paraprake se bashku me arsyen e mos -mbylljes**

Avancet janë mbyllur në kohën e duhur, mirëpo gjatë procesit të mbylljes ka ndodhur një gabim në regjistrimin kontabël për shkak të përdorimit të kodit të pasaktë në program. Hapja e avancit është regjistruar në kodin **42300**, ndërsa mbyllja është evidentuar gabimisht në kodin **11313**. Si pasojë e këtij mospërputhjeje, në pasqyrat financiare avanci rezulton gabimisht si i hapur, edhe pse në realitet ai është mbyllur.

- **shpalos veprimet e ndërmarra për mbylljen e tyre, përfshirë ndalesën ne page apo inicimin e procedurave ligjore për kthimin e tyre**

Gabimi në regjistrimin kontabël të avancit është vërejtur pas përmbylljes së vitit fiskal. Edhe pse është paraqitur kërkesë për korrigjim, rezultoi se gjatë vitit fiskal 2025 ka pasur mungesë të mjeteve financiare, çka ka pamundësuar realizimin e korrigjimit brenda këtij viti. Si rrjedhojë, avanci vazhdon të paraqitet si i hapur në pasqyrat financiare. Korrigjimi do të realizohet me buxhetin e vitit 2026, menjëherë pas bartjes së gjendjes së avanceve në regjistrat kontabël, përmes regjistrimit korrektues përkatës.

## Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

| Departamenti | Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025 | | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024-1 | | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023-2 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar |
| ADMINISTRATA QENDRORE - MZHE | 56 | 43 | - | 40 | - | 38 | - |
| ZYRA E MINISTRIT - MZHE | 18 | 16 | - | 18 | - | 17 | - |
| MONITORIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE | 30 | 11 | - | 20 | - | 9 | - |
| UJI DHE HEDHURINA | - | - | - | - | - | 18 | - |
| DEP.I PZHE -INTEGRIMET EVROPIANE | 8 | 8 | - | 8 | - | 9 | - |
| DEPARTAMENTI LIGJOR | 7 | 6 | - | 6 | - | 5 | - |
| INSTITUTI GJEOLOGJIK I KOSOVËS | 33 | 21 | - | 20 | - | 21 | - |
| AKEE | - | - | - | - | - | 5 | - |
| DEPARTAMENTI I POSTË-TELEKOMUNIKACIONIT | 12 | 9 | - | 4 | - | 8 | - |
| DEPARTAMENTI I ENERGJISË | 20 | 17 | - | 20 | - | 4 | - |
| MINIERAT | 10 | 2 | - | 9 | - | 14 | - |
| INSPEKTORATI | 10 | 8 | - | 2 | - | 2 | - |
| **Gjithsej** | **204** | **141** | - | **147** | - | **150** | - |

## Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontratë për shërbime të veçanta

| Departamenti | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025 | | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024-1 | | Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023-2 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar | Me orar të plotë | Me orar të shkurtuar |
| DPTIK | 5 | - | 8 | 2 | 9 | 3 |
| AKEE | - | - | 1 | 2 | 4 | 3 |
| BREE | - | 1 | - | - | - | - |
| DFSHP | 1 | - | 1 | - | 1 | - |
| NJPMNP | 1 | - | 1 | - | - | - |
| Divizioni i prokurimit | - | 1 | - | - | - | - |
| Departamenti I Energj | 1 | 1 | - | - | - | - |
| **Gjithsej** | **8** | **3** | **11** | **4** | **14** | **6** |

**Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave te angazhuar.**

Gjatë vitit financiar 2025, institucioni ka angazhuar persona fizikë për kryerjen e shërbimeve të veçanta, bazuar në kontrata për shërbime profesionale dhe/ose teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e prokurimit publik.

Këto angazhime nuk përbëjnë marrëdhënie pune në kuptim të ligjit të punës, pasi personat e angazhuar nuk kanë qenë të punësuar me kontratë pune, nuk kanë përfituar të drejta që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe nuk janë përfshirë në listën e pagave të institucionit.

Pagesat e realizuara për këto shërbime janë bërë në bazë të kontratave përkatëse, faturave ose raporteve të punës së kryer, dhe janë evidentuar në pasqyrat financiare si shpenzime për shërbime të jashtme / shërbime të veçanta, sipas klasifikimit ekonomik përkatës.

Në kuadër të **DPTIK-së**, respektivisht në kuadër të Rrjetit për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës (KREN) janë angazhuar 5 persona fizik për kryerjen e shërbimeve të veçanta (si në tabelë).

Rrjeti për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës (KREN) është krijuar në vitin 2021 si një iniciativë kyçe në kuadër të projektit të Ekonomisë Digjitale të Kosovës (Projekti KODE) me investim kapital 4.7 milionë EUR dhe shpenzime operacionale vjetore mbi 300 mijë EUR.

KREN është krijuar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë (ME/Njësia për Zbatimin e Projektit) dhe administron Qendrën e të Dhënave me vendndodhje në ITP Prizren. Qëllimi kryesor i KREN-it është fuqizimi i transformimit digjital në hulumtim dhe edukim, nxitja e inovacionit dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të avancuara, me një qëllim më të gjerë për të përmirësuar qasjen në shërbimet brezgjerë me shpejtësi të lartë dhe për të përmirësuar cilësinë e infrastrukturës digjitale në ambientet edukative dhe hulumtuese. Ky rrjet në mënyrë specifike u shërben institucioneve akademike, institucioneve të arsimit të lartë (IAL-ve), si dhe rreth 250 shkollave fillore dhe të mesme, duke ofruar një rrjet të dedikuar, me performancë të lartë që i lidh ato brenda Kosovës dhe i ndërlidh ato në rrjetin akademik pan-evropian, GÉANT.

Duke qenë se aktualisht KREN ende nuk ka një status të përcaktuar, por vepron si entitet brenda Ministrisë së Ekonomisë, asetet janë në pronësi të Ministrisë dhe stafi i angazhuar ka qenë i financuar nga Projekti i Ekonomisë Digjitale në Kosovë, atëherë për Ministrinë, sigurimi i qëndrueshmërisë së KREN-it pas përfundimit të projektit KODE ka qenë dhe është krucial për vazhdimësinë e operimit të shërbimeve për të gjithë komunitetin e përdoruesve.

Në kuadër të **NJPMNP-së**, z Palokë Berishaj, është angazhuar si ekspert në fushën e Ndërmarrjeve Publike në ME/ NJPMN nga data 21.03.2024 deri 21.03.2025 me orar të plotë.

Fushëveprimi i përgjithshëm i ekspertit ka qenë në fushën e qeverisjes korporatave e shtrirë në udhëzimet për Ministrinë e Ekonomisë/NJPMNP-në në përmirësimin e qeverisjes korporatave të ndërmarrjeve publike dhe gjithashtu në realizimin e qëllimeve të aksionarit në krijimin e sistemit efikas dhe efektiv të veprimtarisë së ndërmarrjeve publike në të mirë të klientëve të tyre duke ofruar shërbime cilësore në vend.

Në kuadër të **DFSHP-së**, gjatë periudhës gjashtëmujore, nga nëntori 2024 deri në maj 2025, angazhimi i Ekspertit PE ishte i domosdoshëm për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale në fushën e multimedias brenda Divizionit për Komunikim me Publikun. Ky angazhim u realizua në funksion të zbatimit të fushatave mediale për informimin e publikut lidhur me masat për subvencionimin e pajisjeve shtëpiake efiçiente dhe të sistemeve diellore për ngrohjen e ujit, të financuara nga pakoja prej 75 milionë euro e Bashkimit Evropian. Qëllimi i angazhimit ishte sigurimi i informimit të saktë, transparent dhe në kohë të qytetarëve.

Në kuadër të **DE-së:** Personi fizik i angazhuar me orar të shkurtuar **është punësuar si rezultat i domosdoshmërisë për themelimin e njësisë implementuese për zbatimin e projektit *"Implementimi i masave të efiçiencës së energjisë në nivel komunal"*, i financuar përmes kredisë nga KfW.**

Personi fizik i angazhuar me orar të plotë **është punësuar si rezultat i domosdoshmërisë për respektimin e obligimeve që rrjedhin nga skema qeveritare për mbështetjen e punësimit të të rinjve, duke dhënë kontribut në mbështetjen e aktiviteteve që lidhen me përgjegjësitë e Divizionit për Planifikim Strategjik dhe Bashkëpunim Rajonal.**

Në kuadër të **BREE**, është angazhuar një person, gjë që ka qenë e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve profesionale të mirëmbajtjes dhe azhurnimit të platformës elektronike për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Konkretisht, gjatë vitit 2025, Ministria e Ekonomisë ka zhvilluar ankandin konkurrues për projektin e energjisë së erës, ku i gjithë komunikimi me ofertuesit, përfshirë publikimin e dokumenteve, njoftimet, sqarimet dhe dorëzimin e pyetjeve, është realizuar përmes kësaj platforme elektronike.

Për këtë arsye, ka qenë i nevojshëm angazhimi i një eksperti të specializuar me qëllim të sigurimit të funksionimit të pandërprerë, sigurisë teknike dhe përditësimit në kohë të platformës gjatë gjithë procesit të ankandit.

Ky angazhim ka pasur karakter teknik dhe të kufizuar në kohë dhe ka qenë thelbësor për garantimin e transparencës, barazisë së trajtimit të ofertuesve, si dhe mbarëvajtjes së proceseve konkurruese.

Vlen të theksohet se ky shërbim më herët është ofruar nga donatori **USAID**, përmes projektit të zbatuar nga **Tetra Tech**.

## Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit ( ZKA)

| NR. | Rekomandimet | Veprimi i menaxhmentit | Afati i zbatimit | Statusi aktual i rekomandimit | Vlerësimi i rrezikut |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Çështja A1**<br>Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve | **Rekomandimi A1**<br>Ministrja duhet të siguroj që janë marrë veprime konkrete në koordinim edhe me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjen adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. | Janë ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve buxhetore, me qëllim që ato të planifikohen në ndarje adekuate të buxhetit. Është siguruar që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të realizohen sipas kategorive ekonomike përkatëse, në përputhje me planin kontabël në fuqi | Në vijimësi | Zbatur | I MESEM |
| **Çështja B1**<br>Mangësi në regjistrimin e pasurive | **Rekomandimi B1**<br>Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosja në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evenidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale. | Janë ndërmarrë masa për sigurimin e regjistrimit të plotë dhe të saktë të pasurisë, si dhe për azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrave përkatës. Gjatë procesit të regjistrimit është shtuar kujdesi për evidentimin korrekt të pasurive, ndërsa gabimet e identifikuara në regjistrin e pasurive janë korrigjuar. | Në vijimësi | Zbatur | I MESEM |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Çështja A2** Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontigjente | **Rekomandimi C1** Ministrja duhet të siguroj një kontroll dhe koordinim me efektiv në mes zyrës ligjore dhe avokaturës shtetërore me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informata, dhe që shënimet në PFV të prezantohen të sakta. | Në përputhje të plotë me rekomandimin përkatës, Zyra Ligjore e Ministrisë së Ekonomisë do të vijojë mbajtjen e një regjistri të detajuar, në koordinim të ngushtë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Avokaturën Shtetërore." | Në vijimësi | Zbatuar | I MESEM |
| **Çështja A3** Vonesë në procesin e vlerësimit të tenderëve | **Rekomandimi A3** Ministrja duhet të siguroj që themelimi i komisionit të vlerësimin e ofertave të bëhet me kohë, në mënyrë që procesi i vlerësimit të përfundoj brenda afateve të përcaktuara. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse, duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit dhe për të shmangur vonesat në nënshkrim të kontratave. | Me qëllim të evitimit të vonesave në procesin e vlerësimit të tenderëve ZKA përmes Vendimeve për emërimin e Komisioneve dhe grupeve punuese ka përcaktuar se Komisioni duhet të përfundoj këtë proces brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh. | Në vijimësi | Zbatuar | I MESEM |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **<u>Çështja A3 –</u>** Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit të brendshëm | Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Po ashtu, duhet të përmbushen objektivat duke mbuluar fushat e përcaktuara në planin vjetor të auditimit. | Sipas Ligjit për zyrtarët publik do të ndërmarrën masa disiplinore sipas përgjegjësisë. | Në vijimësi | Zbatuar | I MESEM |

**<u>Shpalos në detaje shënimet në tabelë:</u>**

- shpalos rekomandimet e bartura nga viti paraprak dhe te pazbatuara, përpjekjet e bëra dhe rezultatet
- shpalos nivelin e zbatimit te rekomandimeve te auditimit te brendshëm te OB